



Stadi: 03/02/2017

Aplikim për vizë me qëllim punësimi
Sipas §26, kreu 2, Rregullorja e Punësimit
(Për shtetas nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Ish-Republika Federale e Jugosllavisë, Mali i Zi dhe Serbia.)

Shënim hyrës:

Shtetasve të gjashtë shteteve të lartpërmendura u njihet vetëm në raste shumë të rralla e drejta e mbrojtjes përmes statusit të refugjatëve, duke qenë se vijnë nga „shtetet e origjinës së sigurt“. Kush udhëton në Gjermani dhe parashtron një kërkesë azili dhe vazhdon të qëndrojë derisa kjo kërkesë e tyre për azil të refuzohet, duhet të llogarisë që ndaj tyre do të vendoset një ndalim-hyrjeje në Gjermani dhe në gjithë zonën Schengen për një periudhë të gjatë kohore.

Megjithatë, nga data 1 janar 2016, për shtetasit e këtyre gjashtë shteteve vlen një rregullore e re për nisjen e një marrëdhënieje punësimi për çdo lloj pune. Për të hyrë në Gjermani me qëllim fillimin e një pune nevojitet një vizë, për të cilën ju duhet të aplikoni në ambasadën gjermane në shtetin tuaj përkatës të origjinës, apo në shtetin e vendbanimit tuaj të zakonshëm. Aplikimi për vizë nuk është i mundur në Gjermani.

Personat, të cilët brenda 24 muajve para aplikimit për vizë, kanë qëndruar në Gjermani si azilkërkues ose si të toleruar (Gedultete) dhe kanë pranuar përfitime mbi bazën e ligjit të përfitimeve për azilkërkuesit, sipas rregullorës së re nuk mund të marrin vizë.

Kjo ndalesë nuk vlen për personat, të cilët kanë parashtruar një kërkesë azili mes 1 janarit 2015 dhe 24 tetorit 2015, dhe që më datën 24 tetor kanë qenë ende në Gjermani dhe pastaj janë larguar menjëherë nga Gjermania.

Udhëzime rreth procedurave për vizë

Në mënyrë që kërkesa juaj për vizë të mund të shqyrtohet shpejt, këshillohet që të respektohet procedura në vijim.

Para se të caktoni një takim për aplikim për vizë, ju duhet të keni dokumentacionin në vijim:

- Ofertën me karakter detyrues të vendit të punës apo kontratën tashmë të nënshkruar të punës me një punëdhënës konkret në Gjermani.
- Miratimin paraprak të autoriteteve gjermane përgjegjëse për punësimin.

Hapi i 1-rë: Kërkimi i një vendi pune tek një punëdhënës konkret në Gjermani.

Për të udhëtuar në Gjermani duhet të keni një ofertë pune me karakter detyrues nga një punëdhënës në Gjermani dhe një vizë kombëtare.

Nëse keni gjetur një punë të përshtatshme, kërkoni prej punëdhënësit ofertën me karakter detyrues të punës, përkatësisht kontratën konkrete të punës. Kjo duhet të përmbajë të dhëna të plota për punëdhënësin dhe punëmarrësin (emrin e plotë të punëmarrësit dhe punëdhënësit përkatësisht të kompanisë, adresën, të dhënat e kontaktit) dhe të marrëdhënies së punës (fillimi i kontratës, lloji i kontratës, paga bruto, orari i punës, koha e pushimeve, shërbimet e veçanta).

Këshillohet të përpilohen së paku tri kopje të njëjta (të nënshkruara nga punëdhënësi i ardhshëm dhe ju personalisht) të ofertës së punës me karakter detyrues, përkatësisht të kontratës së punës.

Hapi i 2-të: Marrja e pëlqimit nga autoritetet gjermane kompetente për punësim

Në mënyrë që të mund t'ju jepet viza, nga autoritetet gjermane kompetente kërkohet miratimi për punësimin. Për punëdhënësin tuaj pikë direkte kontakti është - sipas rastit - ose Zyra Federale e Punës ose Zyra për të Huajt.

Se cila nga dy autoritetet është përgjegjëse, varet nga fakti nëse ju keni qëndruar më parë për një kohë të gjatë në Gjermani (p.sh. si azilkërkues ose i toleruar, për shkollim, studime ose kurs gjuhe, për punësim apo për më shumë se 3 muaj). Prandaj, ju duhet që punëdhënësit tuaj t'i jepni informacione gjithëpërfshirëse rreth qëndrimeve tuaja të mëhershme në Gjermani. Ju lutemi kini parasysh, që këto informacione do të verifikohen gjatë procedurës së mëposhme për pajisje me vizë, dhe të dhënat e mangëta apo të pasakta mund të çojnë në refuzimin e kërkesës për vizë, apo për së paku në stërzgjatjen e kohës së përpunimit të kërkesës tuaj.

Udhëzim: Për disa profesione të caktuara, në mënyrë të veçantë për profesionet në sektorin e shëndetit apo infermierisë, në Gjermani do t'ju duhet një leje për ushtrimin e profesionit. Informacione mbi këtë gjeni në linkun e mëposhtëm:

http://ec.europa.eu/growth/tools-databases/regprof/index.cfm?action=regprofs&idcountry=3&quid=1&mode=asc&maxRows=*#top

Nëse do të keni nevojë për një leje të ushtrimit të profesionit, atëherë ju ose punëdhënësi juaj duhet të lidhet paraprakisht me autoritetet përgjegjëse gjermane.

Informacione mbi njohjen e profesionit gjeni në linkun e mëposhtëm:

<https://www.anerkennung-in-deutschland.de/html/de/index.php>

Kompetencat dhe procedura:

Alternativa 1: Ju keni qëndruar më herët për një <u>periudhë afatgjatë</u> në Gjermani, apo keni <u>kërkuar azil</u> në Gjermani. Qëndrimet afatgjata janë ato qëndrime, për të cilat ju keni disponuar një lejeqëndrimi, një kartë blu të BE-së, një lejeqëndrimi të pakufizuar, një leje për qëndrim të përhershëm (Komuniteti Evropian), një lejeqëndrimi tolerimi (Duldung) apo qëndrimi i lejuar në kuadër të një procedure azili.	Alternativa 2: Ju nuk keni qenë <u>asnjëherë</u>, përkatësisht keni qëndruar vetëm për një <u>periudhë të shkurtër</u> në Gjermani. Me qëndrime afatshkurta nënkuptohen qëndrimet me qëllim vizite, qëndrimet turistike dhe qëndrimet tjera deri në 90 ditë. (Te shtetasit e Kosovës: qëndrimet me një vizë Schengen-i)
1. Punëdhënësi i juaj i drejtohet Zyrës	1. Punëdhënësi juaj i drejtohet Drejtorisë

<p>përkatëse për të Huajt, aty ku ndodhet vendi i juaj i ardhshëm i punës, me dokumentacionin dhe të dhënat në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Originalin e ofertës me karakter detyrues të vendit të punës apo kontratës tashmë të nënshkruar të punës - Ekstraktin nga regjistri tregtar për kompaninë - Të dhënat rreth periudhave dhe vendeve të qëndrimeve tuaja të mëhershme - Të dhënat tuaja personale në vijim: Emri i plotë (si në pasaportë), data e lindjes, vendi i lindjes, shtetësia, vendbanimi i tanishëm. <p>Shënim: Kompetencën në nivel lokal e ka Zyra për të Huajt, që është përgjegjëse për selinë e punëdhënësit.</p>	<p>Rajonale të Zyrës Federale të Punës që mbulon Lejimin në Tregun e Punës me dokumentacionin dhe të dhënat në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Originalin e ofertës me karakter detyrues të vendit të punës apo kontratës tashmë të nënshkruar të punës.
<p>2. Zyra përgjegjëse për të Huajt verifikon gjatë procedurës të dhënat tuaja në lidhje me qëndrimet e mëhershme. Kjo zyrë verifikon gjithashtu, nëse keni shfrytëzuar shërbime mbi bazën e ligjit të shërbimeve për azilkërkuesit.</p>	
<p>3. Zyra për të Huajt përfshin në një procedurë të brendshme Zyrën Federale të Punës. Zyra Federale e Punës verifikon kontratën tuaj të punës dhe në rastin e plotësimit të të gjitha kushteve paraprake, ajo jep miratimin e saj.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Me këtë rast mund të jenë të nevojshme informacione të tjera nga punëdhënësi juaj, të cilat Zyra Federale e Punës do t'i kërkojë më pas prej tij. 	<p>2. Zyra Federale e Punës verifikon kontratën tuaj të punës apo kualifikimit profesional, dhe në rastin e plotësimit të të gjitha kushteve paraprake, ajo jep miratimin e saj.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Me këtë rast mund të jenë të nevojshme informacione të tjera nga punëdhënësi i juaj, të cilat Zyra Federale e Punës do t'i kërkojë më pas prej tij.
<p>Udhëzime rreth kushteve paraprake ligjore për dhënien e miratimit nga Zyra Federale e Punës</p> <ul style="list-style-type: none"> - Për vendin e lirë të punës nuk duhet të ketë punëkërkues të privilegjuar (si p.sh. një punëkërkues gjerman apo qytetar i BE-së - që ka aplikuar për atë vend pune). - Të ardhurat dhe kushtet e punës nuk duhet të jenë më të disfavorshme sesa për një punëmarrës të krahasueshëm në Gjermani. 	
<p>Pas kryerjes së verifikimit punëdhënësi juaj/ju do të marrë/merrni nga Zyra për të Huajt miratimin për dhënien e vizës, që tashmë përfshin lejen e punës dhe verifikimin e nevojshëm të sigurimit të jetesës.</p>	<p>Pas kryerjes së verifikimit, punëdhënësi i juaj/ju do të merrni nga Zyra Federale e Punës miratimin për dhënien e një lejeje qëndrimi.</p>

Hapi i 3-të: Procedurat e vizës në ambasadat gjermane

Caktimi i takimit

Sapo të keni marrë miratimin paraprak nga Zyra për të Huajt përkatësisht lejen për punë nga Zyra Federale e Punës, ju mund të rezervoni një takim për të aplikuar për vizë tek ambasada gjermane në vendin tuaj. Ju lutemi kini parasysh, që aplikimi mund të bëhet vetëm në ambasadat përkatëse në vendin e tuaj të origjinës, ose në shtetin e vendbanimit tuaj të zakonshëm.

Takimet mund të rezervohen në linkun e mëposhtëm:

https://service.diplo.de/rktermin/extern/choose_realmList.do?request_locale=de&locationCode=tira

https://service.diplo.de/rktermin/extern/choose_realmList.do?locationCode=tira&request_locale=en
Aplikuesit, që nuk kanë rezervuar paraprakisht një takim, nuk do të pranohen.

Lutemi të mbani në konsideratë, që rezervimi i një takimi mund të bëhet vetëm me numrin e pashaportës (jo të kartës së identitetit) dhe se duhet të tregohet kujdes për gërmat kapitale. Nëse numri pashaportës në konfirmimin e regjistrimit nuk përputhet plotësisht me numrin faktik në pashaportën tuaj, nuk do të lejoheni në sportelet e Ambasadës dhe duhet të rezervoni një takim të ri.

Aplikimi për vizë

Ju duhet të paraqiteni personalisht e në kohën e duhur në takimin e caktuar dhe me të gjitha dokumentat në vijim. **Ju lutemi kini parasysh, që aplikimi me dokumentacion jo të plotë mund të çojë në refuzimin e kërkesës për vizë, përkatësisht në stërzgjatjen e kohës së përpunimit të kërkesës tuaj.**

- Pasaportë e vlefshme udhëtimi dhe dy fotokopje
- Dy formularë aplikimi të plotësuar në tërësi dhe të nënshkruar personalisht nga ju (Formularët e aplikimit mund të merren falas në ambasadën gjermane apo të shkarkohen në faqen e saj të internetit)
- Tre fotografi biometrike, aktuale, të formatit të pasaportës me sfond të në ngjyrë të çelët
- Tarifa e vizës dhe shpenzime të mundshme. Tarifat dhe detyrimet duhet të paguhen **kesh në monedhën shqiptare LEK**. Tarifa është 60 Euro përlogaritur me kursin aktual të këmbimit, plus një tarifë e përgjithshme prej 500 lekësh
- Origjinali i ofertës me karakter detyrues të vendit të punës (me të dhëna për pagën, kohën e punës dhe pushimet) ose origjinali i kontratës së punës, dhe dy fotokopje
- Origjinali i miratimit të autoritetit përkatës në Gjermani (Zyrat për të Huajt ose Zyra Federale e Punës)
- Për profesione të vecanta – shih më lart – leja e profesionit

Në rast të paraqitjes së dokumentacionit të plotë dhe të të dhënave të sakta viza jepet përgjithësisht brenda disa ditësh.

Shënim: Gjatë procedurës së vizës, konstatimi i të dhënave jo të sakta në lidhje me qëndrimet e mëhershme në Gjermani, mund të çojë në refuzimin e kërkesës tuaj për vizë.

Tërheqja e pasaportës

Në rast të pajisjes me vizë ju do të merrni një vizë kombëtare gjermane me periudhë vlefshmërie prej 6 muajsh, e cila ju jep të drejtë udhëtimi për në Gjermani. Pasi të keni udhëtuar në Gjermani, në

vendbanimin tuaj të ri jeni të detyruar të aplikoni një lejeqëndrimi pranë Zyrës përkatëse për të Huajt.

Udhëzime për bashkim familjar

Nëse keni qëllimin të udhëtoni bashkë me familjen tuaj për në Gjermani, për secilin anëtar veç e veç duhet të kërkohet një vizë kombëtare për Gjermani. Udhëtimi pa vizë apo udhëtimi me vizë Schengen (shtetasit kosovarë) nuk është i mundur. Dhënia e vizave për anëtarët e familjes suaj mbështetet në rregulloret e përgjithshme për bashkimin familjar, dhe nënkupton që ju vetë të jeni të pajisur më një vizë sipas Rregullores për Punësimin neni 26 pika 2. Më shumë informacione mund të merrni nga fletë-informacionet përkatëse në faqen e internetit të ambasadës gjermane në vendin tuaj të origjinës. Ju lutemi kini parasysh në mënyrë të veçantë rregulloret rreth njohurive të nevojshme të gjuhës gjermane dhe të sigurimit të jetesës (përfshirë hapësirën e banimit dhe sigurimin shëndetësor).

Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.